



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ITALIANE**



**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ C (3)**

Ngarkesa: 6 kredite, 20 lex, 40 orë seminare

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program studimi profesional dyvjeçar në “Komunikim Shumëgjuhësh në Insitucion dhe Ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat lëndore: Lënda Italisht si gjuhë e huaj (Niveli A2.1) si gjuha e tretë e huaj synon t’u japë studentëve njohuri bazë gjuhësore dhe aftësi komunikuese. Objektivat e mësimit dhe përmbytjet bazohen në këto tre fusha:

1. Njohuritë:

- a. Përfitim i njohurive të zgjeruara gramatikore në përputhje me nivelin e synuar gjuhësor
- b. Përfitim i njohurive të zgjeruara leksikore dhe në fjalor në përputhje me nivelin e synuar gjuhësor
- c. Përfitim i njohurive të thelluara fonetike në përputhje me nivelin e synuar gjuhësor

2. Aftësitë:

Studentët zhvillojnë aftësitë e mëposhtme:

- a. janë në gjendje të diskutojnë për tema të njohura si familja, koha e lirë, shëndeti, puna dhe udhëtimet;
- b. mund të shprehin mendime të thjeshta dhe të kërkojnë e japin informacion në biseda të thjeshta;
- c. mund të shkruajnë tekste të shkurtra dhe të lidhura, si email-e, raporte të shkurtra dhe histori të thjeshta, në të cilat përshkruajnë përjetime, përvoja dhe plane;
- d. janë në gjendje të kuptojnë dialogë të thjeshta, biseda dhe udhëzime në situata të përditshme, p.sh. te mjeku, në trafik apo gjatë blerjeve;
- e. janë në gjendje të lexojnë dhe të kuptojnë tekste të thjeshta, si artikuj të shkurtër gazetash, njoftime dhe letra personale.

3. Kompetencat:

Studentë janë në gjendje:

- a. të shprehën më me siguri në gjuhën gjermane në situata të ndryshme të përditshme, si blerjet, udhëtimet, vizitat te mjeku apo në punë;
- b. të ndjekin progresin e tyre në mësim, për të forcuar gjuhën dhe për të përsëritur e zbatuar strukturat gramatikore;
- c. të sillen në mënyrë të përshtatshme, si gjuhësisht ashtu edhe kulturore, në situata tipike të jetës së përditshme gjermane;
- d. të reflektojnë mbi përparimin e tyre gjuhësor dhe të gjejnë mënyra për të përmirësuar sistematikisht njohuritë e tyre të gjuhës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE**



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

GJUHE E HUAJ E DYTË C (3)

Ngarkesa: 6 kredite E.C.T.S, 20 orë leksione/40 orë seminare

Viti akademik: Viti II, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Programi i Studimit Profesional Dyvjeçar në “Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivi e përgjithshme lëndore: Të zhvillohet aftësia e studentit për të përdorur gjuhën frënge në situata të ndryshme komunikimi reale dhe autentike. Të rritet ndërgjegjësimi për regjistrat e ndryshëm të gjuhës përmes përdorimit të materialeve autentike. Të stimulohet motivimi dhe kureshtja e studentëve për kulturën franceze dhe për përdorimin e gjuhës si mjet komunikimi ndërkulturor. Të nxiset pjesëmarrja aktive dhe e vetëdijshme e studentit në procesin e të nxënës, duke zhvilluar strategjitë dhe teknikat që çojnë drejt autonomisë në të nxënës. Të aftësohet studenti për të reflektuar dhe për t'u sjellë në mënyrë të përshtatshme në kontekste të ndryshme komunikimi: personale, publike, profesionale dhe akademike.

Rezultate të pritshme lëndore:

Në përfundim të kësaj lënde, studenti pritët të jetë në gjendje të:

- Kuptojë dhe përdorë shprehje të thjeshta dhe të zakonshme nga jeta e përditshme.
- Prezantojë veten dhe të tjerët në mënyrë të saktë dhe të përshtatshme.
- Bëjë dhe kuptojë pyetje të thjeshta që lidhen me vendbanimin, marrëdhëniet, profesionin apo jetën personale.
- Japë dhe marrë informacione bazë nëpërmjet komunikimit të thjeshtë e të qartë.
- Përdorë gjuhën në situata të përditshme për të komunikuar qëllime të menjëhershme.
- Bashkëpunojë me të tjerët në grup për realizimin e aktiviteteve të ndryshme gjuhësore dhe ndërkulturore.
- Demonstrtojë ndërgjegjësim për përdorimin e gjuhës në kontekste të ndryshme kulturore dhe sociale.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHES SPANJOLLE**

**PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
GJUHË E HUAJ C (2)**

Ngarkesa: 6 kredite; 20 seminare; 40 leksione

Viti akademik/Semestri kur zhvillohet: Viti i I, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Program profesional dyvjeçar në "Komunikim shumëgjuhësh në institucione dhe ndërmarrje. "

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Objektivi kryesor i kursit është që studenti të jetë i aftë të ndërveprojë përmes kompetencës komunikative që ofron Niveli A2, i përshkruar në MCERL (Manuali i referencës).

Objektivat specifike lëndore:

- o të jetë i aftë të përshëndesë dhe të prezantohet në spanjisht
- o të numërojë, të dallojë gjininë e emrave dhe të përdorë nyjet e tyre
- o të flasë për profesionet dhe të përshkruajë shkurt klasën apo shtëpinë e tij
- o të zgjedhë foljet e kohës së tashme, mënyra dëftore
- o të krijojë një fjalor bazik për komunikim të thjeshtë në spanjisht

Rezultatet e pritshme.

Në fund të kursit studentët do të kenë konsoliduar aftësitë e tyre të folurit, shkruarit dhe komunikuarit në gjuhën spanjolle.

Konceptet themelore:

Data, dita dhe ora

Te ftojmedhe ti pergjigjemifteses

Shprehje e dakortesiseapomosdakortesise

Kohet e shkuara te menyresdeftore

Koha e ardhme e menyresdeftore

Te flasim per te shkuaren, ngjarjetapokujtimettona, ngjarjehistorikeetj

Te flasim per te ardhmen